



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA ADMINISTRIMIT PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. _____ Prot.

Kukës me, _____.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. 28 Datë 22.05.2024

PËR

**DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË SIP.0,5 HA, NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR,
PËR OBJEKTIN HEC "MALLA" (SHTESE) NË FUNKSION TË AKTIVITETIT TË
SHOQËRISË "GJURR REÇ" SH.P.K**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.1/b,27,54/e ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të RSH", ligjin Nr.57/2020, datë 30.04.2005, "Për pyjet" neni 25, ligjin Nr.9693, date 19.03.2007 "Per fondin kulllosor" (i ndryshuar) neni 10, VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", VKM Nr 888 date 27.12.2022 "Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetar apo zgjerimin e tyre" kreu II pika 15 VKM VKM Nr.592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kulllosor", (i ndryshuar), pika 6/d, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjore dhe kulllosore publik"kerkesen e Subjektit nr 13 date,01/05/2024 "Per marrjen ne perdorim te siperfaqes pyjore/kulllosore, si dhe urdherin e Kryetarit Bashkise nr 281 date 14.05.2024,i propozoj Këshillit Bashkiak Kukës, të:

MIRATOJË:

1.Dhënie ne perdorim nga fondi pyjore/kulllosore (ekonomija pyjore Arren) te siperfaqes 0,5 ha,qe preken nga ndertimi i kanalit per shtrirjen e tubacionit HEC "Malla" (shtese) për:

a).Ngastrat me të dhënat e mëposhtme:

41/b,44/b,47/b51/c52/a52/c53/a56/a


2.Pas Shprehjes dakortesise do te vazhdohet, me vijimin e proçedurave ligjore te dhenies ne perdorim te siperfaqes pyjore/kullosore si dhe lidhjes se kontrates.

3.Afati i dhenies ne perdorim eshte 2 (dy) vjet me te drejte rinovimi.

4.Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe prokurimeve Publike,dhe Drejtoria Administrimit Pyjeve dhe Kullotave.

KRYETARI

Albert HALILAJ



Konc. S.Hallaçi

Ligjshmeria: H.Muja

Sekretari: E.Ramallari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr _____ Prot _____

date ____/____/2024

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË SIP.0,5 HA, NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR, PËR OBJEKTIN “HEC MALLA” (SHTESE) NË FUNKSION TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË “GJURRA REÇ” SH.P.K

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 te miratuar me date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b,27,54/e, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet” neni 25, ligjin Nr.9693, date 19.03.2007 “Per fondin kullosor” (i ndryshuar) neni 10, VKM Nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, ”, ndryshuar me V.K.M Nr. 684 datë 02.09.2020, V.K.M Nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorise së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetare apo zgjerimin e tyre” paragrafi II pika 15 , VKM Nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, (i ndryshuar), pika 6/d, si dhe Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016“Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjore dhe kullosore publik”si dhe Urdherin e Kryetarit Bashkise nr 281 date 14.05.2024 “Per vazhdimin e procedurave per zvoglimin ne volum te fondi pyjore dhe kullosore publik te nje siperfaqe prej 0,5 ha ne ekonomine pyjore “Arren” te Bashkise Kukes per ndertimin e kanalit per shtrirjen e tubacionit per

hec "Malla" (shtese) nga Shoqeria "Gjurr Reç" sh.p.k, si dhe kërkesen e Subjektit nr 13 date 01/05/2024 "Per marrjen ne perdorim te fondit pyjore/kullosore" bashkangjitur ju paraqesim per miratim P/Vendimin:

"Per dhenien ne perdorim te nje sip. prej 0,5 ha nga fondi pyjor dhe kullosor, per objektin "HEC Malla" shtese ne funksion te aktivitetit te shoqerise " Gjurr Reç" sh.p.k

Ne baze te VKM Nr.433, datë 08.06.2016, Bashkive iu transferuan në pronësi sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listave të inventarit bashkangjitur ketij vendimi. Sipas dispozitave te percaktuara ne nenin 25 te ligjit Nr.57/2020, date 04.05.2020 , "Per Pyet" si dhe nenin 10 te ligjit Nr.9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosore" (i ndryshuar), njesite e veteqeverisjes vendore ne ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave, per kërkesat e paraqitura nga subjekte juridike ose fizike për veprimtari energjitike, etj. kane te drejte qe te zbatojne procedurat ligjore per:

- ndryshimin e destinacionit për një sipërfaqe kullote.
- Ndryshimine e destinacini te tokave te pyjeve dhe tokave me bimësi pyjore.

Subjekti ekonomik "Gjurr Reç" sh.p.k, i cili ushtron aktivitetin e tij tregtar ne fushen e infrastruktures energjitike, i eshte miratuar kontrata e konçensionit e formes (BOT) Nr.7036 Rep, date 13/06/2013, nr 2138 kol per ndertimin e hec "Malla" e nenshkruar me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise.

Subjekti me kërkesen nr 13 prot date, 01/05/2024 i eshte drejtuar Bashkise Kukes dhe ka kerkuar marrjen me qera te tokes pyjore toke qe preket nga ndertimi i kanalit te HEC-it.

1.Procedura per heqjen/marrjen ne perdorim te fondit pyjore/kullosore te nje siperfaqe prej 0,5 ha, e cila preket nga aktiviteti energjistik, kalon neper disa faza, si me poshte vijon:

a). Ne baze te udhezimit Nr 1 date 09/06/2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjore dhe kullosore publik" pika 22 pika f bazuar ne V.K.M Nr. 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorise së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetare apo zgjerimin e tyre" paragrafi II pika 15, si dhe VKM Nr.1374, date 10.10.2008 (i ndryshuar) eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik per siperfaqet pyjore/kullosore qe preken nga aktiviteti i ndertimit te HEC "Malla"(shtese).

b). Nga Drejtoria e Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave prane Bashkise Kukes, eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik per siperfaqen e propozuar, si dhe kerkon dhenin e pelqimit per fillimin e procedurave per dhenie ne perdorim te siperfaqes fond pyjore/kullosore qe administrohet nga Bashkia Kukes qe preket nga ndertimi i kanalit per shtrirjen e tubacionit per Hec "Malla" (shtese) nga Shoqeria "Gjurr Reç" sh.p.k.

- Sipas te dhenave te regjistrit kadastral pyjor/kullosor, rezulton se siperfaqja e propozuar shtrihet ne ngastrat: 41/b,44/b,47/b51/c52/a52/c53/a56/a te cilat ben pjese ne ekonomine pyjore/kullosore "Arren" dhe jane ne administrim te Bashkise Kukes.
- Raporti i hartuar nga Drejtoria e Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave, permban nje studim te hollesishem te te dhenave mbi listen e ngastrave/nenngastrave, pershkrimin e siperfaqes pyjore/kullosore, vleresimin financiar te siperfaqes se propozuar.

a) Sipas pikes 5/ç te VKM Nr 591, date 9.10.2018 si dhe pikes 6/d te VKM nr 592 date 9.10.2018 percaktohet se: *Miratimin me shkrim per vazhdimin e procedurave te dhenies ne perdorim te fondit pyjore/kullosore, behet me vendim te Keshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ te te cilit eshte siperfaqja pyjore/kullosore.*

2. Pas miratimit te procedurave ligjore te dhenies ne perdorim te siperfaqes fondit pyjore/kullosore behen disa veprime nga strukturat e meposhtme:

- Drejtoria perkatese e Administrimit pyjeve dhe kullotave ben perditesimin ne kadastrin pyjore ne vellim dhe te dhenat i percjell ne Ministri.
- Ministria ben perditesimin ne kadastrin Kombetare te Pyjeve:

Sa me siper, i propozojme Keshillit Bashkiak Kukes, dhenien e dakortesise per vijimin e procedurave ligjore per dhenien ne perdorim per kryerjen e aktivitetit te ndertimit "HEC "Malla" (shtese) nga subjekti "Gjurra Reç" sh.p.k.

Ju faleminderit !

DREJTORI
Sali HALLAÇI